

SHTATOR 2022 | Nr. 19

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

TRANSPARENCA, MEKANIZMI MË I MIRË NË KOMUNIKIMIN E
EFIKASITETIN E INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË





FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË Z. ARTUR METANI NË TRYEZËN “Komunikimi i Organeve të Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë me Median dhe Publikun”

Është kënaqësi të jem në këtë tryezë ku do diskutohet mbi temën e komunikimit të institucioneve të drejtësisë me median e publikun dhe gjej rastin të falenderoj Këshillin e Evropës për këtë organizim, por edhe për mbështetjen e vazhdueshme ndaj institucioneve tona përmes CEPEJ.

Komunikimi është një fushë shumë e gjerë, e në evoluim të vazhdueshëm, po aq sa vetë teknologjia e informacionit dhe padyshim që çdo eksperiencë, model e praktikë është e nevojshme për një ndërveprim efikas me opinionin publik dhe median, me synim sjelljen e punës dhe veprimtarisë së sistemit të drejtësisë sa më pranë publikut, direkt apo përmes

medias, në mënyrë sa më të arritshme e transparente. Tashmë mbi 5 vjet nga miratimi i Reformës në Drejtësi, një nga sfidat kryesore për secilin nga institucionet tona mbetet pritshmëria publike për punën dhe rezultatet e sistemit, për një drejtësi që vepron njëjloj ndaj padrejtësisë e kulturës së pandëshkueshmërisë.

Prandaj puna e institucioneve të drejtësisë vëzhgohet, gjykohet e paragjykohet, diku me të drejtë e diku jo. Jetojmë në kohë sfidash, ku rendja pas sensacionit apo përfitimit politik të ditës, fatkeqësisht është bërë një një trend, i cili le pak ose aspak hapësirë për përmbajtjen, për mendimin e thelluar e profesional.

Sa më mirë të komunikojmë punën dhe aktivitetin tonë, aq më mirë do kuptohen ato në publik. E për këtë padyshim që kemi nevojë për të diskutuar e marrë ekspertizën më të mirë.



Dashje pa dashje edhe institucionet e drejtësisë përballen me këtë situatë, natyrisht bashkë me problematikat e veta. Por kjo nuk duhet të na bëjë të stepemi apo të mbyllemi në komunikimin publik.

Personalisht mendoj se nuk duhet të kemi frikë nga kritikata, sepse nuk mund të vetë konsiderohemi të pagabueshëm, por padyshim që duhet të dimë të qëndrojmë mbi interesat e ditës së aktorëve e faktorëve publikë, duke u fokusuar tek misioni ynë.

Mendoj se një mekanizëm shumë i mirë mbrojtës është transparenca, përmes një strategjie të mirë komunikimi, për prezantimin cilësor të punës sonë, si për rritjen e forcimit të besimit të publikut tek drejtësia, ashtu edhe për fuqizimin e funksionimit dhe rolit të vetë institucioneve tona, në arritjen dhe ruajtjen e pavarësisë dhe paanshmërisë së magjistratëve.

Padyshim që në epokën e fake news, kjo nuk është e lehtë sepse pikërisht “lajmet e

rreme” janë ato që rrisin paragjykimin reciprok mes institucioneve e medias dhe publikut përmes saj. Por duke mos e parë si pengesë, por si mundësi, një strategji e mirë komunikimi do ndihmonte për t’u përballur me këto sfida, së pari duke ndërtuar një marrëdhënie korrekte me median, pikërisht bazuar në fokusin e përbashkët, që si institucione kemi me të: opinionin publik.

Sa më mirë të komunikojmë punën dhe aktivitetin tonë, aq më mirë do kuptohen ato në publik. E për këtë padyshim që kemi nevojë për të diskutuar e marrë ekspertizën më të mirë. Sa dhe si duhet komunikuar? Si duhet të përballojmë situatat sfiduese? Këto dhe të tjera pyetje padyshim që do marrin përgjigje gjatë këtyre dy ditëve nga ekspertët e nderuar të Këshillit të Evropës, por edhe kolegët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë që ka iniciuar këtë tryezë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju faleminderit dhe punë të mbarë kësaj tryeze!



TRANSPARENCA, MEKANIZMI MË I MIRË NË KOMUNIKIMIN DHE EFIKASITETIN E INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani mori pjesë në tryezën me temë “Komunikimi i Organeve të Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë me Median dhe Publikun”, një aktivitet i projektit SEJIII të Këshillit të Evropës në mbështetje të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Kjo tematikë u diskutua mes tre institucioneve të reja të drejtësisë, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ekspertë të CEPEJ (Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në

Shqipëri) dhe KEDNJ për lirinë e shprehjes dhe medias.

Në fjalën e tij përshëndetëse Z. Metani vërejtë se pritshmëritë e larta publike mbi punën dhe rezultatet e sistemit, për një drejtësi që vepron njëjloj ndaj padrejtësisë e kulturës së pandëshkueshmërisë, bëjnë që institucionet e reja të drejtësisë të jenë në fokus, të vëzhgohen, gjykohen e paragjykohen, me apo pa të drejtë.

Por kjo, tha Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nuk duket të sjellë stepje apo frikë nga

“Pritshmëritë e larta publike mbi punën dhe rezultatet e sistemit, për një drejtësi që vepron njëjloj ndaj padrejtësisë e kulturës së pandëshkueshmërisë, bëjnë që institucionet e reja të drejtësisë të jenë në fokus, të vëzhgohen, gjykohen e paragjykohen, me apo pa të drejtë. Por kjo, nuk duket të sjellë stepje apo frikë nga kritikë, por vetëpërmbytje dhe impenjim për të qëndruar mbi interesat e ditës së aktorëve e faktorëve publikë, duke u fokusuar tek misioni ynë”.



kritikat, por vetëpërbajtje dhe impenjim për të qëndruar mbi interesat e ditës së aktorëve e faktorëve publikë, duke u fokusuar tek misioni ynë.

“Mendoj se një mekanizëm shumë i mirë mbrojtës është transparenca, përmes një strategjie të mirë komunikimi, për prezantimin cilësor të punës sonë, si për rritjen e forcimit e besimit të publikut tek drejtësia, ashtu edhe për fuqizimin e funksionimit dhe rolit të vetë institucioneve

tona, në arritjen dhe ruajtjen e pavarësisë dhe paanshmërisë së magistratëve.”, nënvizoi mes të tjerash Z. Metani.

Në ditën e dytë të tryezës “Komunikimi i Organeve të Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë me Median dhe Publikun”, këshilltarja për komunikimin dhe median e ILD-së, Znj. Mimoza Koçiu bëri prezantimin “Strategjitë e komunikimit. Modeli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.





BASHKËPUNIMI ME CEPEJ, HISTORI SUKSESI

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e përfaqësuar nga Inspektorja jomagjistrate Znj. Joana Asimi, përcolli gjatë një konference rajonale, në Budva të Malit të Zi, eksperiencën e ILD si një prej institucioneve përfituese të programit “Instrumenti Horizontal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”, përmes projektit të Forcimit të Efiçencës dhe Cilësisë së Drejtësisë në Shqipëri, CEPEJ.

Në sesionin mbi efiçencën e drejtësisë, të kësaj konference, Znj. Asimi mbajti fjalën “Forcimi i Cilësisë dhe efiçencës së drejtësisë në Shqipëri (SEJ III), eksperiencia e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.”

“Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Projektin “Forcimi i Cilësisë

dhe Efiçencës së Drejtësisë në Shqipëri” (SEJIII) filloi që në muajt e parë të ekzistencës së ILD-së, në vitin 2020- tha mes të tjerash Inspektorja Asimi,- duke u nisur nga identifikimi i fushave të asistencës, tek zhvillimi i kapaciteteve dhe ndërlidhja me institucione homologe europiane.

Ky bashkëpunim solli si rezultat antarësimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Inspektimit (RESIJ), për shkëmbimin e eksperiencave dhe krijimin e praktikave të inspektimit, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane, e më tej organizimin në Tiranë, në qershor 2022, të Konferencës Ndërkombëtare me temë “Interesi i publikut në administrimin e



drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve”. Konferenca, e para e kësaj natyre në Shqipëri, bëri bashkë drejtues dhe përfaqësues të shërbimeve të inspektimit të drejtësisë nga vendet e Bashkimit Evropian, konkretisht të Belgjikës, Bullgarisë, Francës, Greqisë, Italisë, Portugalisë, Rumanisë, Spanjës, Shqipërisë si dhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, të cilët ndanë përvojat dhe ekspertizën, sesi shërbimet e inspektimit të drejtësisë mund të arrijnë në punën e

tyre, një ekuilibër të drejtë midis mbrojtjes së interesit publik dhe respektimit të pavarësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve.”

Në konferencën përmbyllëse programit “Instrumenti Horizontal të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, krahas Shqipërisë merrnin pjesë edhe Kosova, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.





NEGOCIATAT E ANTARËSIMIT ME BE, ILD NË TAKIMIN SHPJEGUES ME KOMISIONIN EUROPIAN

Bruksel, 27 Shtator 2022

Në kuadër të procesit të negociimit të Shqipërisë me BE, një ekip nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ishte pjesë e delegacionit shqiptar, që mori pjesë në takim shpjegues të organizuar në Bruksel nga Komisionin Europian, mbi kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, Ecuria e Acquis dhe standardet përkatëse prej shtatorit 2018 e në vazhdim.

Delegacioni shqiptar kryesohej nga znj. Majlinda Dhuka, kryenegociatore dhe Znj. Adea Pirdeni, zv. Ministre e Drejtësisë, si institucioni negociues për kapitullin 23, si dhe përfaqësues të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u përfaqësua me drejtoreshën e

Drejtorisë së Analizës Ligjore dhe Hartimit të Akteve Znj. Eljona Bylykbashi dhe ndihmësen në Kabinet Znj. Linda Saliu.

Ekipi teknik i Komisionit Europian nga Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit si dhe nga Departamenti për Drejtësi, kanë paraqitur para delegacioneve të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut parimet dhe standardet e BE-së për sistemin gjyqësor, pavarësinë, cilësinë dhe efikasitetin e tij; kërkesat e legjislacionit të BE-së përkundër atij kombëtar; pavarësinë e gjyqësorit, kërkesat për të; emërimi, promovimi dhe vlerësimi i magjistratëve; llogaridhënia e magjistratëve në kuadër të procedimeve disiplinore; trajnimi gjyqësor; mospërputhja



me parimet e BE, instrumentet e matjes së standardeve, e më tej edhe për politikat antikorruption, mbrojtjen e të dhënave personale, mosdiskriminimin, të drejtat e fëmijëve, barazinë gjinore e lirinë e medias.

Takimet shpjeguese janë faza e parë e procesit të shqyrtimit (screening), që përfshin gjithë spektrin e politikave e legjislacionit të BE-së, i konceptuar në 6 grupime për të 35 kapitujt e trupës së ligjeve

të BE-së (Acquis), që u mundëson vendeve kandidate të familjarizohen me ligjet dhe standardet e BE-së dhe detyrimet që ato mbartin, si hapi i parë në procesin e negociatave të antarësimit.

Faza e dytë do jenë takimet dy palëshe, ku secili vend kandidat ftohet të paraqesë, sipas kapitullit të caktuar, ecurinë e përgatitjeve për miratimin dhe zbatimin e trupës së ligjeve të BE-së.



SEKTORI I NDIHMËS JURIDIKE DHE ANKESAVE



Gjatë asistimit të ankuesve

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues cdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të

shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.


Gjatë muajit Shtator 2022, Sektori i Ndihmës Juridike dhe Ankesave ka pritur 29 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 23 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.





Edhe gjatë muajit Gusht ILD ka ofruar asistencë të plotë për dorëzim dokumentacioni nga qytetarët apo institucionet.

ANKESAT NË ILD



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas ligjit dhe komunikon me kërkuesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik. Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit Shtator, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **12 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t'i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- ⇒ mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- ⇒ të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në

⇒adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13, Tiranë.

⇒ mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin "Si pranohen ankesat".

SHTATORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Shtator** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **59 ankesa**, **58** nga të cilat janë paraqitur nga qytetarët dhe **1 ankesë** nga institucion.

Edhe gjatë muajit **Gusht**, ILD ka ofruar asistencë të plotë për dorëzim dokumentacioni nga qytetarët apo institucionet, 46 ankesa janë paraqitur, nga të cilat 45 nga qytetarë dhe 1 ankesë nga institucion.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Shtator** 2022. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME

99 vendime arkivimi nga 158 praktika të shqyrtuara:

- 53 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (ILD);
- 17 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (dosje të mbartura nga ish KLD);
- 9 vendime arkivimi pas verifikimit (ILD);
- 20 vendime arkivimi pas verifikimit (dosje të mbartura nga ish KLD).

VERIFIKIME

32 vendime verifikimi, nga të cilat:

- 26 vendime verifikimi, shqyrtim fillestar (ILD);
- 3 vendime verifikimi, shqyrtim fillestar (dosje të mbartura nga ish KLD);
- 3 vendime vijim verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);


HETIME DISIPLINORE

- 1 vendim për fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrat;
- 3 vendime për vazhdim të hetimit disiplinor për 6 magjistratë
- 1 vendim mbyllje hetimi disiplinor për 1 magjistrat
- 1 kërkesë për procedim disiplinor për 1 magjistrat

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, nga ankues, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.

Gjatë muajit Shtator 2022, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka bërë 75 shpallje publike.



ANKETA- DUAM MENDIMIN TUAJ PËR ILD-NË

Komunikimi me publikun në funksion të transparencës mbetet një prioritet i vazhdueshëm për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Për të rritur komunikimin me qytetarët, Zyra e ILD ka hartuar dhe publikuar në faqen e internetit një Anketë, përmes së cilës kërkohet mendim mbi punën e deritanishme të institucionit. Anketa mund të plotësohet online ose fizikisht pranë ILD-së.



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PRITI NJË DELEGACION PARLAMENTAR NGA ZAKSEN ANHALT TË GJERMANISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani priti deputetë – anëtarë të Komisionit Parlamentar për Çështjet Federale dhe Evropiane, Media dhe Kulturë të Landit Zaksen Anhalt (Sachsen-Anhalt) të Republikës Federale të Gjermanisë.

Delegacioni gjerman po zhvillon një vizitë zyrtare disa ditore në vendin tonë për t'u njohur me zhvillimet në Shqipëri dhe procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.



Z. Metani bëri një prezantim të funksionit dhe detyrave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si autoriteti shtetëror përgjegjës për hetimin e shkeljeve, për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve në të gjitha nivelet e sistemit, si dhe për inspektimin e gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.



Gjatë bashkëbisedimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë iu përgjigj interesit të deputetëve mbi procedurat e punës së ILD-së dhe rolin e institucionit në kuadër të reformës në drejtësi, në kontribuimin për një sistem gjyqësor sa më llogaridhënës, të përgjegjshëm dhe me integritet.



SHTATOR 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD

**KONTAKT ILD**

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)